

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 21 PRILL 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk dua që diskutimin për aktin normativ “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”, ta gjykoj me efekte pozitive, se si duhet të kishte sjellë rritjen e standardit të jetesës së qytetarëve për t’i mbrojtur ata nga efektet e krizës, që, sido që të jetë, është e paafektuar nga lufta në Ukrainë, mirëpo jo vetëm unë, por as qeveria vetë nuk ka argumente për të na dëshmuar se kjo masë e saj i ka mbrojtur qytetarët. Për aktin normativ që flasim sot, qeveria u detyrua ta sjellë pasi qytetarët mbushën sheshet, sepse çmimet e produkteve të shportës u rritën me 30%, duke filluar nga buka me 20 lekë, vaji arriti çmimin rekord me 400 lekë, mielli, orizi e të gjitha me radhë.

Pra, të jemi të sqartë me shqiptarët dhe të mos bëjmë demagogji me ta. Kjo masë, të cilën sot qeveria kërkon ta kalojë në parlament, nuk erdhi si pasojë e reflektimit të përgjegjshëm të saj, vendimmarrjeve të menjëhershme apo ndjeshmërisë së saj për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve e për t’iu gjendur pranë, por si pasojë e presionit të jashtëzakonshëm të qytetarëve me ditë të tëra në sheshet e të gjithë vendit. Propaganda për t’i bindur shqiptarët se qeveria nuk ishte e papërgjegjshme, vazhdoi me një show të shëmtuar dhe tallës, ku ministra e deputetë morën rolin e inspektorit në dyqanet e vendit, një shfaqje sa qesharake, aq edhe dëshpëruese, që tregon fare qartë dorëzimin e shtetit para kësaj krize që po kalojmë, pasi në një shtet që funksionon mbi bazën e ligjeve dhe të institucioneve, strukturat përgjegjëse inspektuese kryejnë detyrën për të ndaluar abuzuesit me çmimet e produkteve dhe jo show me regji të ministrave në rolin e inspektorit.

Krijimi i bordeve të monitorimit, në fakt, është dëshmia e qartë e dështimit të strukturave shtetërore për të përballuar këtë krizë, që po bëhet e papërballueshme për ekonomitë familjare të shqiptarëve. Krahas rritjes së çmimeve të ushqimeve, ka edhe një rritje të çmimit të karburantit, ku 60% e çmimit të naftës janë taksat e qeverisë “Rama”, e cila edhe në këto momente, kur çmimet kanë shkuar në stratosferë, nuk merr angazhim dhe nuk pranon të heqë taksën e qarkullimit dhe të karbonit, edhe pse propozimi i LSI-së ka javë që fle në sirtarët e parlamentit. Aq frikë ka nga ky debat, sa që vonohet qëllimisht edhe diskutimi i kësaj nisme këtu në seancë plenare, në sy të të gjithë opinionit publik. Ndërkohë, kjo qeveri vijon të pasurohet për shkak të TVSH-së mbi çmimet e rritura, ndërkohë që qytetarët varfërohen çdo ditë. Vetëm përgjatë tre muajve të parë qeveria ka arkëtuar 245 milionë euro, merren pseudomasa që janë të pamjaftueshme për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe nuk bëhet as sa Kosova, sepse halli i kësaj qeverie nuk është kriza ekonomike me të cilën përballen qytetarët, por vetëm pagesat për koncesione, për inceneratorët e aferat e tjera korruptive, të cilave skanerin më të mirë ua bëri raporti më i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit.

Më lejoni t'i citoj: "1. Korrupsion i shtrirë në të gjitha nivelet e qeverisë dhe zyrtarë të përfshirë në praktika korruptive pa u ndëshkuar. 2. Zgjedhje të blera dhe përdorim i të dhënave. 3. Shkelja e privatësisë nga vetë shteti, ku një bazë të dhënash me informacionin personal dhe detajet e kontakteve të rreth 900 mijë qytetarëve, si dhe preferencat e tyre të mundshme partiake, u bë publike duke i ekspozuar votuesit ndaj presionit të mundshëm. 4. Sistemi gjyqësor jofunksional, ku presioni politik, intimidimi, korrupsioni dhe burimet e kufizuara e penguan gjyqësorin të funksiononte plotësisht, në mënyrë të pavarur dhe efikase. 5. Politizimi i emërimeve të kaluara në Gjykatën e Lartë dhe në atë Kushtetuese, i cili kërcënoi të minonte pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve, për të mos folur për policinë e korruptuar, dhunimin e fjalës së lirë e të tjera me radhë, një realitet që sa vjen e përkeqësohet, të cilin vetëm verbëria e maxhorancës së Edi Ramës nuk e sheh dhe, për më keq, përmes një propagande të dalëboje, përpiqet shumë ta fshehtë.

Ndërkohë, para disa muajsh u fol për rritje ekonomike imagjinare. Në raportin e prillit të pasqyrës ekonomike globale, të sapopublikuar nga FMN-ja, parashikohet që ekonomia shqiptare do të rritet këtë vit me vetëm 2%, nga 4,5% që ishte parashikimi në muajin tetor. Vendi ynë vlerësohet se do të ketë rritjen më të ulët në rajon, ndërkohë që Mali i Zi parashikohet ta ketë rritjen në 3,8%; Serbia në 3,5%; Maqedonia e Veriut në 3,2%; Kosova në 2,8% e të gjitha me radhë. Fatkeqësisht, vendi po shkon drejt rrënimit ekonomik si pasojë e keq-qeverisjes, korrupsionit dhe paaftësisë së kësaj qeverie. E gjithë kjo gjendje mjerane, ku ndodhet vendi, ka sjellë një dramë tjetër, atë të shpopullimit. Vetëm në vitin 2021 janë larguar mbi 50 mijë qytetarë, shifër që ka kaluar edhe projeksionet më pesimiste të vetë INSTAT-it. Përballë këtij realiteti e këtyre të vërtetave, të cilat duhet t'i themi në sy, ka nevojë për masa emergjente dhe për vendimmarrje të përgjegjshme dhe aspak për propagandë, sepse vendimet që marrim sot mund të sjellin fatkeqësi kombëtare nesër. Faleminderit!